



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 08.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.06.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Roza Komani B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi i pendave dhe kanaleve te ujitjes në zona rurale , me Nr. të Prok: 632-21-3477-5-1-1, Nr. Brendshëm : 632-21-062-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik “Roza Komani B.I. e dt.29.06.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Sanimi i pendave dhe kanaleve te ujitjes në zona rurale , me Nr. të Prok: 632-21-3477-5-1-1**, Nr. Brendshëm : 632-21-062-5-2-1, kundër **DOSJES SË TENDERIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 11.06.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Përmirësohet **DOSJA E TENDERIT E AUTORITETIT KONTRAKTUES e publikuar me datë: 11.06.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, do të bëjë përmirësimin e Dosjes tenderit-specifikimit teknik;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “Roza Komani B.I., ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sanimi i pendave dhe kanaleve te ujitjes në zona rurale , me Nr. të Prok: 632-21-3477-5-1-1, Nr. Brendshëm : 632-21-062-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 08.07.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti kontraktues, konstaton se disa nga pretendimet e Operatorit Ekonomik "Roza Komani B.I.", janë pjesërisht të bazuara, prandaj do të bëj përmirësimin e Dosjes tenderit-specifikimit teknik;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur që lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivit të Komunës



z. Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit